LIGJ
Nr. 7/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9180, DATË 5.2.2004 "PËR STATISTIKAT ZYRTARE", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:
"c) "Sistemi Kombëtar Statistikor" është tërësia e institucioneve dhe organizatave që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilat mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas programit.".

Neni 2

Në nenin 4, fjalia hyrëse ndryshohet si më poshtë:
"Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Europiane. Organizimi dhe zbatimi i programit udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:".

Neni 3

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Parimet e cilësisë statistikore

Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe për të ruajtur besimin e publikut në to, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:
a) "rëndësia", e cila ka të bëjë me shkallën në të cilën statistikat plotësojnë nevojat aktuale dhe të mundshme të përdoruesve;
b) "saktësia", e cila i referohet vlerësimeve më të përafërta ndaj vlerave reale të panjohura;
c) "koha", e cila i referohet periudhës mes vlefshmërisë së informacionit dhe ngjarjes apo dukurisë që ajo përshkruan;
ç) "përpikëria", e cila ka të bëjë me vonesën ndërmjet datës së nxjerrjes së statistikave dhe asaj të parashikuar për t'u nxjerrë këto statistika;
d) "e drejta e hyrjes" dhe "qartësia", të cilat u referohen kushteve dhe mënyrave, përmes të cilave

[1] *Ky ligj është përafruar plotësisht me:*
Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 "Mbi statistikat evropiane, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Europain dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Europiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 Mbi Statistikat e Komunitetit dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Europiane". Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 87, ***datë 31.3.2009, faqe 164 – 173.***

përdoruesit mund të marrin, përdorin dhe interpretojnë të dhënat;

dh) “krahasueshmëria”, e cila i referohet masës së ndikimit të dallimeve në konceptet e aplikuara statistikore, mjetet matëse dhe procedurat e krahasimit të statistikave mes zonave gjeografike, fushave sektoriale apo kohës së kapërcyer;

e) “koherenca”, e cila i referohet përshtatshmërisë së të dhënave për t’u kombinuar besueshëm në mënyra dhe përdorime të ndryshme.”.

Neni 4

Në nenin 6 pika 3 shkronja “b”, fjala “rezultateve” zëvendësohet me fjalët “statistikave zyrtare”.

Neni 5

Në nenin 7 bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Në fillim të nenit shtohet pika 1 me këtë përmbajtje:

“1. INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Veprimtaria koordinuese përfshin:

a) bashkëpunimin me agjencitë statistikore për projektimin dhe zbatimin e programit;

b) sigurimin e uniformitetit të metodologjisë së përdorur gjatë kryerjes së vrojtimeve statistikore;

c) sigurimin e mbështetjes teknike, në mënyrë që veprimtaria statistikore të përputhet me standardet ndërkombëtare;

ç) kontrollimin e zbatimit të cilësisë statistikore, sipas parimeve të përcaktuara në nenin 4/1 të këtij ligji;

d) pjesëmarrjen në proceset e krijimit të sistemeve kombëtare statistikore të informatizimit;

dh) përfaqësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në sistemin statistikor europian dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe mbajtjen e marrëdhënieve me institutet kombëtare të statistikave të vendeve të tjera.”.

b) Paragrafi ekzistues numërtohet si pikë 2.

c) Shkronja “c” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“c) për të siguruar se statistikat në program janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve të parashikuara në këtë ligj.”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Struktura organizative e INSTAT-it miratohet me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të Këshillit të Statistikave, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Titullari i INSTAT-it emërohet nga Kryeministri, pas kryerjes së një procedure publike rekrutimi nga Këshilli i Statistikave. Mënyra e kryerjes së kësaj procedure, afatet e njoftimit dhe kriteret për vlerësimin e kandidatëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pas kryerjes së procedurës, Këshilli i Statistikave ia propozon kandidaturat e përzgjedhura Kryeministrit, duke i shoqëruar me të gjithë dokumentacionin administrativ të procesit.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohet për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.”.

c) Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kandidati për Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it duhet të plotësojë këto kritere:

a) të ketë kualifikime profesionale në fushën e statistikave;

b) të ketë kryer studime pasuniversitare;

c) të ketë eksperiencë në punë në funksione drejtuese për një periudhë jo më pak se 5 vjet;

ç) të jetë i njohur për reputacionin dhe kompetencën në fushën e statistikës;

d) të ketë aftësi menaxhuese dhe komunikimi.

3/2. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it shkarkohet nga Kryeministri, bazuar në propozimet e Këshillit të Statistikave, vetëm kur përmbushen një a më shumë nga këto raste:

a) shkelje të etikës profesionale;

b) shkelje të rënda administrative dhe/ose shpërdorim detyre;

c) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që e bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

ç) kur dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) kur evidentohen mangësi ose gabime të rënda apo të përsëritura profesionale. Në rast se evidentohen mangësi apo gabime të rënda ose të përsëritura profesionale, vendimmarrja e Këshillit të Statistikave për të propozuar shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it bazuar në këtë rast, merret vetëm nëse janë të këtij mendimi, të paktën, 2/3 e numrit total të anëtarëve të Këshillit të Statistikave.”.

ç) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. INSTAT-i financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga të ardhurat e tjera të ligjshme, të cilat regjistrohen në sistemin unik të thesarit.”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Statusi dhe përbërja e Këshillit të Statistikave

1. Këshilli i Statistikave përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave, duke u bazuar në interesat profesionale për statistikat zyrtare, si dhe në njohuritë mbi metodat statistikore, si përdorues statistikash, sigurues të të dhënave ose për shkak të përfshirjeve të tjera në prodhimin e statistikave.

2. Anëtarët e Këshillit të Statistikave janë përfaqësues të:

a) Bankës së Shqipërisë (1 anëtar);

b) Ministrisë së Financave (1 anëtar);

c) përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare (2 anëtarë);

ç) botës akademike (1 anëtar);

d) shoqërisë civile (1 anëtar);

dh) Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (1 anëtar).

3. Anëtarët e Këshillit të Statistikave shërbejnë sipas kapaciteteve personale. Ata caktohen për një mandat pesëvjeçar, duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati për çdo anëtar të jenë të shpërndara gjatë periudhës pesëvjeçare. Anëtarët kanë të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

4. Anëtarët e Këshillit të Statistikave mund të shkarkohen nga Këshilli i Ministrave kur kryejnë një ose disa nga shkeljet e mëposhtme:

a) mungojnë më shumë se dy herë dhe në mënyrë të përsëritur në mbledhje;

b) ndeshin konflikte interesi me interesat e INSTAT-it;

c) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

ç) kur dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. Pas shkarkimit të anëtarit, Këshilli i Ministrave miraton vendimin përkatës për zëvendësimin e tij.

6. Kryetari i Këshillit të Statistikave nuk duhet të jetë përfaqësues apo punonjës i ndonjë ministrie. Kryetari zgjidhet nga anëtarët e Këshillit të Statistikave. Emërimi hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

7. Rregulla më të hollësishme për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, përzgjedhjes, emërimit e

shkarkimit të anëtarëve, rregullat e funksionimit dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave miratohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 8

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1
Mbledhja e Këshillit të Statistikave

1. Këshilli i Statistikave mblidhet, të paktën, tri herë në një vit kalendarik.
2. Kuorumi përbëhet nga, të paktën, pesë anëtarë të Këshillit.
3. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.”.

Neni 9

Në nenin 11 pika 1, pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“ë) vendos e autorizon përditësimin vjetor të programit vetëm për anën praktike të zbatimit të tij dhe informon Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin për modifikimet e kryera;

f) harton një raport vjetor për funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, duke përfshirë një raport mbi arritjet e programit, për t’ia paraqitur Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, dhe e bën të disponueshëm për publikun.”.

Neni 10

Në nenin 12, shkronja “d” shfuqizohet.

Neni 11

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/1 dhe 12/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1
Bordi Këshillues Statistikor

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it mund t’i propozojë Këshillit të Statistikave ngritjen e një bordi këshillues statistikor, për të diskutuar çështjet që lidhen me Sistemin Kombëtar Statistikor. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, pas argumentimit të nevojave konkrete që ka institucioni për çështje specifike, i propozon Këshillit të Statistikave emrat e anëtarëve, detyrat dhe kohëzgjatjen e punës.

Këshilli i Statistikave ia paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për miratimin përfundimtar të ngritjes së bordit këshillues statistikor. Bordi financohet nga buxheti i INSTAT-it.

Neni 12/2
Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën

1. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryen përditësimin dhe përshtatjen e klasifikimeve statistikore ekonomike dhe sociale, në përputhje me klasifikimet statistikore europiane dhe ndërkombëtare.

2. Ngritja, përbërja, rregullat e funksionimit dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 12

Në nenin 13, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Të gjitha institucionet publike janë të detyruara të informojnë INSTAT-in për krijimin e çdo dokumentacioni të ri me të dhëna administrative apo për ndryshimin e atyre ekzistuese, si dhe duhet të lejojnë INSTAT-in të hyjë e të përdorë këto të dhëna vetëm për qëllime statistikore.”.

Neni 13

Në nenin 15 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Të gjithë punonjësit e organeve/kontrolluesve, të përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike, të cilët vihen në dijeni me të dhënat që përpunojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.”.

c) Në fjalinë e parë të pikës 4, fjalët “me përjashtim të rastit të të dhënave të pikës 3 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “me përjashtim të rastit të identifikimit të drejtpërdrejtë”.

ç) Fjalia e dytë dhe e tretë e pikës 8 shfuqizohen.

d) Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Pas përpunimit të plotë të të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve letër dhe jo më parë se një vit pas publikimit të statistikave zyrtare të prodhuara nëpërmjet përpunimit të këtyre të dhënave, pyetësorët digjen nën mbikëqyrjen e komisionit të ngritur nga INSTAT-i.”.

Neni 14

Në nenin 18, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Të ardhurat nga gjobat derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7959, datë 25.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani